

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Brazilit miraton ekstradimin e Ervin Matës
ADRESA	https://albeu.com/lajme/gjykata-e-brazilit-miraton-ekstradimin-e-ervin-mates/1012737/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:03:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:59:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2fdd8537d74b14de6f6d86e1d4e1db4810a874b6273870422b1927fb8986bfa2
TEKSTI	f6afcc7fb02fd9cd683421f27ae0846d06c52c4cce11ad7f70470c981b1e6e6b
PAMJA	d6bd29a1eb2ebd549b11ca987aee3fc81aa62e2ccb1f61cff48fc3cf98652702

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5c4f99f9a62f1c0a86606713948639aaff88f8f30659565f6ee125bdc775a2a3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5c4f99f9a62f1c0a86606713948639aaff88f8f30659565f6ee125bdc775a2a3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjykata e Brazilit miraton ekstradimin e Ervin Matës



Gjykata Supreme Federale e Brazilit, ka miratuar unanimisht kërkesën e Shqipërisë për ekstradimin e Ervin Matës. Vendimi është marrë nga trupi i parë i gjykatës, në seancën virtuale të zhvilluar nga 14 deri më 21 gusht 2026.

Në vendimin prej 23 faqesh, gjykata braziliane përcakton se dokumentacioni i paraqitur nga autoritetet shqiptare plotëson kushtet ligjore për ekstradim.

Kërkesa lidhet me procedimin penal në Shqipëri për akuza që përfshijnë trafikimin e lëndëve narkotike, bashkëpunimin në një formë të veçantë dhe pjesëmarrjen në grup të strukturuar kriminal.

Në dosje përfshihen edhe të dhëna të siguruara nga komunikimet në aplikacionin e koduar Sky ECC. Sipas materialit të paraqitur para gjykatës braziliane, në shtator të vitit 2020, përdoruesi me identifikuesin GS4TDD, i identifikuar si Ervin Luan Mata, dyshohet se komunikonte për transportin e një sasive prej rreth 250 kilogramësh kokainë nga Brazili drejt aeroportit të Frankfurtit në Gjermani.

Në një komunikim të 29 shtatorit 2020, në dosje përmendet se Mata fliste për sekuestrimin e 240 njësi të mallit në Frankfurt.

Në një tjetër bisedë, ai shprehet se "të gjitha mallrat e mia u sekuestruan në Frankfurt, në doganë", ndërsa përmendet edhe dërgimi i parave përmes personave të tjerë.

Dokumenti brazilian përfshin edhe komunikime që lidhen me Shqipërinë dhe Holandën. Në një prej tyre, Mata shprehet: "Vetëm në Shqipëri dua para", ndërsa në një tjetër përmend shumë prej një milionësh në Holandë.

Në dosje janë përfshirë gjithashtu komunikime me Eralbi Breçanin. Në një bisedë të tetorit 2020, Mata flet për "ngarkesa" dhe për mundësinë e sigurimit të "daljeve të sigurta" për mallin.

të fundit /



Ndërpriten negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së



Qytetarët pranë moshës së pensionit mund të blejnë deri n...



BIK-u urdhëron ekspozimin e flamurit të UÇK-së në institucion...



Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon kryeministri...



Lehtësimi fiskal për karburantet/ Maqedonia e Veriut, Italia, Spanj...



Trump kundërshton rregullat shtesë për Al-n: Mos kini frikë nga...



Real Madridi mund të ndjekë modelin e Ronaldos për ta...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Por Gjykata Supreme Federale e Brazilit vendos një kufizim të rëndësishëm: ajo nuk ka gjykuar nëse Ervin Mata është fajtor apo jo për veprat që i atribuohen.

Gjykata shpjegon se, në procedurat e ekstradimit, kontrolli i saj është i kufizuar dhe nuk përfshin një rigjykim të fakteve, autorësisë apo provave të çështjes penale.

Sipas vendimit, bëhet vetëm një vlerësim paraprak juridik për të përcaktuar nëse plotësohen kushtet për ekstradim. Gjykata konstaton se ekziston parimi i dënueshmërisë së dyfishtë, se veprat nuk janë parashkruar dhe se nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore për ekstradimin.

Ekstradimi është miratuar si procedurë hetimore, pra për t'iu nënshtruar procedimit penal në Shqipëri dhe jo për ekzekutimin e një dënimi të formës së prerë.

Megjithatë, Ervin Mata nuk i dorëzohet automatikisht autoriteteve shqiptare. Vendimi përcakton se dorëzimi varet nga vendimi diskrecional i Presidentit të Brazilit.

Përveç kësaj, Shqipëria duhet të formalizojë garancitë e parashikuara nga ligji brazilian, ndër të tjera që Mata të mos ndiqet penalisht për një fakt tjetër të mëparshëm nga ai për të cilin është kërkuar ekstradimi, t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim në Brazil dhe të mos i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues.

Vendimi i Gjykatës Supreme Federale të Brazilit, është unanim dhe mban datën 24 gusht 2026. Relator i çështjes është gjyqtari Alexandre de Moraes.

Pra, gjykata braziliane i ka hapur rrugë ekstradimit të Ervin Matës drejt Shqipërisë, por dorëzimi fizik i tij mbetet ende i kushtëzuar nga procedurat e përcaktuara në vendim.

Shtuar më 15.09.2026 15:59


Tags: [ekstradimin](#), [Ervin Matës](#), [Gjykata e Brazilit](#), [miraton](#)



Bill Gates: Qeveritë në mbarë botën janë shumë prapa në zhvillimet e...



Ambasadori kroat flet nga Pogradeci: Protestat janë e drejtë e qytetarëve, qever...



Daja i Zegjine Çaushit me çoi në ferra dhe abuzoi me mua/ Rrëfihet 34-vjeçarj...



Zhgënjim i madh për FSHF-në/ UEFA refuzon planin për finalen e madhe në...



Mes dy hidrocentraleve, fshati Madhesh në Mat prej afro 20 vitesh pa energji...



E trishtë/ Ndahet nga jeta ish-deputetja e Kosovës (EMRI)



E ardhmja e Shqipërisë, FSHF me sytë nga Jurgen Klop për ndeshjet ndaj...



Arrestohet në Belgjikë Jasin Avdyli, i dënuar me 12 vite burg në Shqipëri ...

albeu

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi

Kushtet e Përdorimit

Privacy Policy

Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.